

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E PROJEKTIT

**NDRYSHIM I KUSHTEVE TE LEJES
MJEDISORE TE TIPIT B ME**

PN-1604-01-2023

Vendodhja : Autostrada Durres - Tirane,
km 6, Zona Kadastrale 2574, Nr. Pasurise
154/177, Rrashbull, Durres.

Kërkues: Subjekti: "RCF INDUSTRIES"
shpk

Aktiviteti Shtese

PRODHIMI I SKEDAVE ELEKTRONIKE

Hartoi raportin e Permbledhjes Joteknike duke u bazuar ne te dhenat e subjektit:
"ENVIRONMENTAL MANAGEMENT CONSULTANTS" Sh.p.k

Ing. Elidiana Shehu
(Lic. 146, Nr. 5113 Prot, date 28.07.2013)



The stamp contains the text "emcstudio" in a stylized green font, with a small green leaf icon above the 'o'. Below it, in a smaller green font, is "Environmental Management Consultants Itd".

Prill, 2024

Kapitulli 1

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1.1. Qëllimi i Projektit

Qëllimi i projektit është zgjerimi i aktivitetit i cili konsiston në prodhimin e skedave elektronike si rezultat i kërkesave të shumta në tregun e jashtëm.

Ky aktivitet ka për qëllim montimin e komponentëve të veçantë elektronik në një skede duke bërë procesin e saldimit manual të komponentëve si edhe saldimit të skedës në tërësi nëpërmjet makinerisë së saldimit me dallge kallaji.

Ky aktivitet do të ushtrohet në një pjesë të kabanonit ekzistues (sipas planvendosjes bashkëngjitur relacionit teknik) ku aktualisht kompania jonë ushtron aktivitetin “Prodhimi i kasave/mobiljeve prej druri dhe aplikimi i veshjes mbrojtëse” (ID 7.10/b - Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj Shtojce, prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri n.q.s. veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit), aktivitet për të cilin jemi pajisur me leje mjedisore.

Referuar shtojcës 1 të Ligjit nr. 52/2020 “Per disa ndryshime në ligjin nr.10448 dt 14.07.2011 “Per lejet e mjedisit “, i ndryshuar, aktiviteti i prodhimit të skedave elektronike klasifikohet si më poshtë:

Industritë prodhuese të komponentëve elektrik – ID 9.1 - Prodhim i kompjuterëve dhe produkteve elektronike dhe optike n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.

Duke punësuar inxhinier projektues, inxhinier prodhimi, inxhinier montimi si dhe inxhinier teknik me eksperiencë të gjatë në fushën e prodhimit të skedave elektronike, bëhet edhe prodhimi i produkteve me cilësi të lartë. Bashkpunimi i ngushtë si pjesë konsultative e stafit teknik që përbehet nga inxhinierë me eksperiencë të ndërthurur në këtë fushë, do të sjellë një rezultat të lartë në punë.

1.2. Vendodhja e zonës së impiantit

Aktiviteti në vlerësim ndodhet në Autostraden Durrës - Tiranë, km 6, Zona Kadastrale 2574, Nr. Pasurisë 154/177, Rrashbull, Durrës.

Pozicionimi për gjat rrugës Autostrades Durrës - Tiranë, km 6, si edhe afërsia me portin e Durrësit kjo lehtësira në transportin e lendeve të para por edhe produkteve përfundimtare.

Gjithashtu në këtë zonë kemi infrastrukturë ekzistuese duke përfshirë rrjetin e energjisë elektrike si edhe sitemin rrugor. Në këtë shtet janë të ndërtuara objektet dhe janë të instaluar makineritë dhe pajisjet e nevojshme për mbarevajtjen e proceseve të punës për prodhimin e kasave/mobiljeve prej druri dhe aplikimi i veshjes mbrojtëse si edhe për prodhimin e skedave elektronike.




Figure 1: Ortofoto e prones ku zhvillohet aktiviteti

1.3. Informacion për qëndrat e banuara në afërsi të zonës së impiantit

Nga pikëpamja administrative, prona ku zhvillohet aktiviteti ndodhet në Durres.

Vendi ku do të zhvillohet aktiviteti, ndodhet në një zonë mikse urbane dhe industrial. Ne figuren me poshte paraqitet pozisionimi i prones ku zhvillohet aktiviteti ekzistues per prodhimin e casave/mobiljeve prej druri dhe aplikimi i veshjes mbrojtëse dhe aktiviteti i ri i prodhimit te skedave elektronike , ne lidhje me infrastrukturën e rrugore te zones.

Persa i perket zonave te banuar, ne afersi te prones jane identifikuar disa banasa te shperndara ne menyre sporadike. Zona ne fjale karakterizohet nga zhvillime industriale dhe zhvillime ekonomike, kjo per faktin e afersise se kesaje zone me portin e Durrsit dhe shtrirjes pergjat autostrades Durres - Tirane, km 6, e cila krijon lehtesira per transportin e lendeve te para dhe produkteve te gatshme.




Figure 2: Pozicioni i aktivitetit ne lidhje me zonat urbane

1.4. Përshkrimi i projektit teknik

1.4.1 Lendet e para

Lendet e para qe perdoren ne procesin e prodhimit te skedave elektronike jane;


- ❖ Skeda (qarku elektrik)
- ❖ Komponent elektronik;

- ❖ Pllaka alumini;
- ❖ Kallaji (per saldimit e skedes)
- ❖ Tel kallaji (saldim manual)
- ❖ Flusant(alpha ef-2210-tf)
- ❖ Silikon (elastosi n 2189)

1.4.2 Pajisjet dhe makineritë qe do te perdoren ne instalim

Makinerite dhe pajisjet qe do te perdoren ne kete instalim janë:

- ❖ Makineri e saldimit me dallge kallaji Model: IEMME TALOS 2.0;
- ❖ Makineria e aplikimit te salikonit Model: Epson T6;
- ❖ Makineri e trajtimit te mbetjeve nga saldimi (skorje kallaj);
- ❖ Tavolina pune për saldimit manual te komponentëve elektronike;
- ❖ Pajisje paketimi;






Figure 3: Makinerite

1.4.3 Pershkrimi e proceseve te punes;

Makineria e saldimit me dallge kallaji është e gajte 4400 cm dhe perbehet nga

- Zona e sperkatjes me flusant(alpha ef-2210-tf)
- Zona e ngrohjes
- Zona e vaskes se kallajit (depozit me kallaj 475 kg).

Makinera e saldimit me dallge kallaji ka nje perdorim te flusantit prej 120 litra/muaj dhe nje perdorim te kallajit prej 90 kg/muaj.

Procesi i saldimit te skedave elektronike kalon ne disa faza.

- 1- Fillimisht te gjitha komponentët elektronike dhe lendet e para ne tere magazinohen ne zona te veçanta te aksesueshme për cdo sektor. Ne momentit qe lendet e para tërhiqen nga magazina për tu futur ne procesin e prodhimit te skedave elektronike, behet nje vlerësim dhe kontroll paraprak i gjendjes teknike te tyre.
- 2- Me pase te gjitha lendet e para shpërndahen neper tavolinat e punës ku kryhet procesi i saldimit manual te komponentëve ne skedën elektronike. Cdo punonjës nëpërmjet pajisve individuale te punës bene procesin e saldimit manual te komponentetve sipas rradhes dhe llojit te skedës elektronike qe do te prodhohet.
- 3- Pas procesit te saldimit manual te komponentëve behet procesi i saldimit te skedës elektronike ne makinerie e saldimit me dallge:
Skeda fillimisht futet ne vaskën e flusantit. ALPHA EF-2210-TF është një fluks pa VOC, pa halide, pa kolofon/rrëshirë, me pak lëndë të ngurtë pa pastërti, i cili është një nga flukset pa VOC me aktivitet më të lartë që promovon saldimitin pa defekte. Ky proces ndihmon ne pastrimin e eskedes si edhe eleminon jonizimet e skedës duke sjelle ne kete menyre nje proces saldimit me rendiment dhe cilësi te larte.
Pas procesit te trajtimit te skedës me flusant, skeda kalon ne zonën e ngrohjes ku nëpërmjet furrave te makinerisë behet nxehja e skedës deri ne nje temperature te caktuar e cila përgatit skedën për saldimit.
Skeda e nxehur kalon ne vaskën e kallajit ku nëpërmjet dallgëve qe krijohen ne kete vaske behet edhe procesi i saldimit te skedës.
- 4- Pas procesit te saldimit behet kontrolli i skedes se salduar me kallaj dhe saldimit manualisht me havi dore te komponenteve qe mund te mos jene salduar mire gjithashtu edhe saldimit te komponenteve te cilet eshte e pa mundur te saldohen ne saldatricen me dallge kallaji. Ne kete kohe behet edhe kontrolli viziv i skedes ne qofte se ne te ndodhen te gjithë komponentet e duhur.
- 5- Pas kontrollit te skedës, kjo e fundit kalon ne fazën silikonatures ku komponentet e skedes qe kemi salduar duhet ti silikonojme ne cepet e tyre dhe duke i vendosur silikon

midis komponentit dhe skedes qe komponenti te ngjitet me skeden per te qene me i qendrueshem nga dridhjet e ndryshme. Ky proces kryhet nga nje makineri e vogel robotike e cila vendos automatikisht silikonin ne skede sipas programit qe i kemi vendosur, ne pozicione te caktuara.

- 6- Pas procesit te silikonatures kalohet ne fazën ne te cilen ne bejme mbylljen mekanikisht te skedes ne nje pjese prej alumini ne te cilen vidosim skeden dhe pastaj izolojme me silikon te gjitha pjeset ku kalojne kabllot dhe ne fund e mbylлим me nje mbulese prej llamarine.
- 7- Me pas skeda kalon ne fazën e programimit dhe testimit. Ne kete faze skedën e programojme me ane te nje programatori te posatshem dhe me pas bejme testimin e saj duke e lene per 30 minuta.
- 8- Pasi kemi kryer testin dhe skeda eshte OK vazhdojme me paketimin e saj duke e futur ne nje qese per ta mbrojtur nga gervishtjet dhe pastaj ne kuti kartoni

Kapaciteti i projektuar i prodhimit te skedave elektronike është rreth 50 000 cope / vit.

1.4.4 Mbetjet qe gjenerohen dhe sistemi i aspirimit

E gjithë sipërfaqja e kapanonit ku ushtrohet aktiviteti i ri i prodhimit te skedave elektronike është i pajisjur me nje sistem aspirimi i cili bene te mundur kapjen dhe nxjerrjen jashtë kapanonit te pluhurit apo te tymrave qe vijnë nga saldimi edhe pse ne kete raste janë ne sasi te vogla referuar kjo edhe teknologjisë se avancuar te makinerisë se saldimit me dallge kallaji.

Mbetjet qe gjenerohen nga ky proces janë:


- ❖ Mbetje nga ambalazhet e përbëra te cilat subjekti i ka ne lejen aktuale jedisore
- ❖ 19 12 03 - Metale joferrore (mbetje skorje kallaji)

Mbetjet nga ambalazhet ruhen ne instalim deri ne momentin qe tërhiqen nga subjekte te licensuara për menaxhimin e tyre.

Mbetjet nga skorjet e kallajit gjenerohen nga makineria e saldimit me dallge kallaji, ne vaskën e kallajit.

Këto mbetje trajtohen ne makinerinë MGR Electro e cila shërben per ndarjen e skorjeve nga kallaji. Ky instalim redukton ndjeshëm mbetjet e kallajit qe gjenerohen nga vaska e saldimit te skedave elektronike. Ne kete menyre mbetjet e kallajit qe gjenerohen pasi trajtohen nëpërmjet pajisjes MGR Electro, riperdoren serisht. Rendimenti i kësaj pajisje mesatarisht arrin deri ne 70% te ndarjes se kallajit per ripërdorim nga pjesa tjetër e mbetjes.

Pjesa e rikuperuar është kallaji i pastër ne masën 70% te sasisë se mbetjes dhe riperdoret serisht. Pjesa tjetër e mbetjes është mbetje skorje kallaji e cila ruhet ne instalim ne ene te posaçme deri ne momentin qe do te tërhiqen nga subjekte te licensuara.



LINEA SMD

MATERIALE SMD

AREA SILICONATURA

BURN IN E COLLAUDO

AREA IMBALLO

BAGNI

BAGNI

bagni

BAGNI

BAGNI

ufficio

ufficio

sala riunione

spogliatoio

mensa

infermeria

chiusura con parete

46	710	800	1243	800	1400	800	1400
	2050		46	1955	46	2340	45
	2095			2000		2400	

3615

3615

600

600

600

600

600

600

1

2

3

4

G

F

E

D

C

B


A

1

2

3

4



Kapitulli 2 PËRSHKRIMI I MJEDISIT

2.1. Mjedisi fizik

Prona ku ushtrohet aktiviteti ndodhet në Autostraden Durres - Tirane, km 6, Zona Kadastrale 2574, Nr. Pasurise 154/177, Rrashbull, Durres.

Gjeologjia

Tokat në zonën ku propozohet të zbatohet projekti janë toka të kripura sodike. Tokat e kripura janë toka të formuara mbi depozitime aluviale lumore dhe detare, me teksturë të lehtë (ranore) dhe më pak mbi ato liqenore e kënetore me teksturë të hollë, në kushte të klimës mesdhetare fushore të ndikuar nga deti, ku regjimi ujqor veçanërisht gjatë verës është djersitës (raporti reshje: avullim është më i vogël se 1). Përgjithësisht gjenden në fusha me kuotë të ulët, shpesh nën nivelin e detit, që në mënyrë periodike ose të përhershme janë të ngopura me ujë. Të formuara në kushtet kur evapo-transpirimi mbizotëron mbi reshjet dhe ujitjen në një pjesë të konsiderueshme të vitit, kripërat që përmbahen në tretësirën tokësore, pas avullimit të ujit, mbeten dhe akumulohen në sipërfaqe ose në një farë thellësie.

Në zonën në studim janë të përhapura tokat e nëntipit Të kripura sodike, për të cilat karakteristike është ndërthurja e procesit të kripëzimit me atë të sodifikimit. Këto toka kanë strukturë të mirë por për shkak të shpëlarjes progressive, kjo strukturë mund të prishet. Në prishjen e strukturës ndikon edhe rritja e përqindjes së Na. Për rrjedhojë, ulet në mënyrë të ndjeshme përshkueshmëria nga uji, kushtet fizike të tokës, vështirësohet plugimi etj.

Për shkak të nivelit të lartë të kripës dhe efektit toksik të Na (I cili gjendet në përmbajtje të lartë), rritja e bimësve në këto toka është e vështirë dhe fauna tokësore është pak aktive në këto mjedise.

Sizmiteti

Zona Tiranë - Durrës përfshihet në zonën e burimeve sizmike të Ultësirës Paramalore (Pranadriatike), të vlerësuar me magnitudë maksimale të pritshme të termeteve $M_{max} = 7.0$ (Aliaj et al., 2004), prapërfshihet në një nga zonat sizmogjene më të fuqishme të vendit tonë, me potencialin sizmik të pritshëm të lartë. Bazuar në të dhënat historike dhe në ndërtimin gjeologjik, duhet theksuar se zona në studim, në veçanti pjesa bregdetare pranë Durrësit, ndodhet pranë ballit mbihypës të Orogjenit Shqiptar dhe për këtë arsye lëvizjet në ngjeshje këtu janë nga më të fuqishmet, dhe janë shkaktare të gjenerimit në këtë zonë të termeteve nga më të fortët që kanë prekur vëndin tonë, me magnitudë deri afër $M = 7$ ose $I_0 = 9-10$ ballë.

Gjeomorfologjia

Zona e propozuar për zhvillimin e projektit gjendet në pjesën perendimore të vendit. Relievi karakterizohet nga pjerrësi e vogël me drejtim nga periferia në qendër, e cila kushtëzohet nga mënyra e formimit të saj. Pjesa më e madhe e saj në të kaluarën zihej nga kënetë e Durrësit, e cila kishte trajtën e një lagune pasi lidhej me detin nëpërmjet kanalit të Porto Romanos. Si rrjedhojë e bonifikimit kjo kënetë u tha dhe u përfituan rreth 7 800 ha tokë arë.

Hidrografia

Zona është e varfër në burime ujore sipërfaqësore natyrore por përshkohet nga një rrjet i dendur kanalesh kulluese, prania e të cilave i dedikohet kryesisht punimeve të kryera për bonifikimin e ish kënetës së Durrësit. Rreth 10 km në vijë ajrore në veri është grykëderdhja e Erzenit, i cili rrjedh në lindje dhe veri të zonës. Rreth 5 km në perëndim të saj shtrihet vija bregdetare e Adriatikut.




Figure 4: Harta hidrogeologjike e zonës në vlerësim

Ujërat nëntokësorë

Zona shtrihet nën pellgun ujëmbajtës të rrjedhjes së poshtme të lumit Erzen, ujërat e të cilit ndahen në dy grupe kryesore:

Ujëra nëntokësore të shkëmbinjve të shkrifët ose kompleksi i depozitimeve Kuartenare, të cilat takohet në shtresat me përshkrueshmëri të vogël deri të mjaftueshme, të tipit lagunor- kënetor, të formuar në fushën e ish Durrësit. Shtresa kolektore ujëmbajtëse e rërave të imta që takohet në

fushën e Durrësit ka përshkueshmëri të dobët dhe veti kolektore të vogla. Karakteri lokal dhe i kufizuar i veçorive ujëmbajtëse të këtyre shtresave shpjegohet me faktin se ato shtrihen në formë “Oreole” mbi ujërat e kripura detare, të cilat kanë desitet më të madh se ujërat e ëmbla. Duke u ndodhur në kushte të tilla, shfrytëzimi i këtyre ujërave pa kriter dhe sasi më të mëdha se ato të rekomanduara, sjell menjëherë prishjen e ekuilibrit hidrogeologjik ekzistues me pasojë depërtimin e ujërave të kripura detare dhe prishjen e cilësisë së tyre, duke i bërë ato praktikisht të pashfytëzueshme.

Ujërat nëntokësore të shkëmbinjve kompakte ose i shkëmbinjve mollasik. Meqënëse depozitimet argjilo – alevrolite të Pliocenit përbëjnë ekranin e papërshkrueshëm argjilor, kompleksi ujëmbajtës në pakot ranore të depozitimeve të Mesinianit, brenda rajonit të studiuar, ka përhapje të vogël dhe tregues hidrodinamikë të vegjël.

Thellësia e ujërave nëntokësore nga sipërfaqja e tokës, në rajonin e ish kënetës së Durrësit arrin 0.5 deri 3.0 m. Gjatë periudhës së thatësisë së verës niveli i ujit ulet 3.0-5.0 m, ndërsa gjatë dimrit 0.2–0.3 m. Në ekstremin perëndimor e lindor të rajonit kemi të bëjmë me ujëra nëntokësore me shtrirje të nivelit në thellësinë mbi 5.0 m nga sipërfaqja e tokës. Në këto thellësi ujërat nëntokësore janë të tipit artezian, ato takohen në ndërshtresa ranoro- konglomeratike të cilat janë të izoluara nga sipërfaqja e tokës nga një shtresë e përshkrueshme argjilore, por që gjatë shpimit këto ujëra ngrihen dhe dalin me vetderdhje në sipërfaqe.

Tokat

Karakteristike për zonën ku propozohet të realizohet ndertimi i objektit me destinacion arsimit, janë Tokat e Hinjta Kafe. Formimi i tyre kushtëzohet nga klima mesdhetare kodrinore, që karakterizon zonën dhe shkëmbinjtë terrigjenë që e përbëjnë atë. Karakteristikë e përgjithshme e këtyre tokave është ngjyra e hinjtë kafe, përbërja mekanike më e rëndë në horizontin B, reaksioni neutral dhe lehtësisht bazik. Këto janë toka minerale, me shkallë të ndryshme të diferencimit të profilit dhe prirje argjilizimi në shtresën e mesme të tij. Formula e profilit të tokave të hinjta kafe është A1-A2-AB-BC-C ose A-AC-C. Ato kanë përmbajtje mesatare humusi dhe azoti në horizontin A, të varfra me P, të pasura me K dhe CaCO₃, si dhe të saturuara me baza. Këto toka kanë përgjithësisht cilësi dhe strukturë fizike të mirë për shkak të përmbajtjes së humusit, CaCO₃ dhe bazave në kompleksin thithës.

Klima

Shtrirja përgjatë bregdetit Adriatik, ndikimi aktiv i detit, relievi i ulët fushor, vargmalet që e rrethojnë nga lindja me shtrirjen e tyre karakterisike veriperëndim-juglindje dhe që e mbrojnë nga

erërat e ftohta dhe të forta kontinentale, janë faktorët themelorë që kushtëzojnë veçoritë klimatike të zonës në studim.

Rajonit ku gjendet zona e propozuar për zhvillimin e aktivitetit bën pjesë në zonën me klimë mesdhetare fushore, nënzona qëndrore. Regjimi klimatik i kësaj zone është tipik mesdhetar. Temperatura mesatare vjetore është 16.1°C. Në muajt e verës temperatura mesatare luhet midis 23.6°C dhe 26°C, ndërsa në muajt e dimrit temperatura mesatare është rreth 8.9°C. Muaji më i nxehtë i vitit është gushti. Temperatura maksimale absolute arrijnë në 39-40°C ndërsa ajo minimale është -7.4°C. Vlerat e temperaturave të vegjetacionit lëkundën në rreth 5000 orë duke e bërë zonën shumë të favorshme për rritjen e mjaft kulturave bujqësore.

Për shkak të veprimtarisë së gjerë ciklonare sasia më e madhe e reshjeve vihet re në gjysmën e ftohtë të vitit ndërsa ajo më e ulët në periudhën e ngrohtë të tij. Sasia mesatare vjetore e reshjeve të zonës në studim, të cilat bien kryesisht në formë shiu, është 972 mm. Sasia më e madhe, rreth 70%, bie gjatë periudhës tetor-shkurt. Minimumi vjetor i regjistruar në zonë është 640 mm ndërsa vlera maksimale e tyre është 1550 mm. Muaji me më shumë reshje është muaji nëntor me 132.9 mm, i ndjekur nga dhjetori me 113 mm. Më pak reshje regjistrohen në korrik me një mesatare 23.9 mm. Numri i ditëve me reshje ≥ 1.0 mm varion nga 2.4 ditë (korrik) deri në 11.1 ditë (dhjetor). Gjatë vitit ka mesatarisht 86.4 ditë me reshje ≥ 1.0 mm.

Era është një tjetër element i rëndësishëm klimatik. Në përgjithësi mund të thuhet se zona karakterizohet nga vlera të larta të qetësisë (rreth 53% të kohës) dhe shpejtësi mesatare minimale 1.2 m/s gjatë verës dhe shpejtësi mesatare maksimale 2.1–2.4 m/s në dimër. Erërat që fryjnë nga verilindja janë dominuese gjatë gjithë vitit dhe vlerën maksimale e arrijnë në dimër me 4.7 m/s.

Në pranverë shfaqet drejtimi i dytë dominues, jugperëndimor me rastisje 11.9%. Ndikimi i jugperëndimit vazhdon të jetë i fortë gjatë verës, ndërsa gjatë vjeshtës forcohet përsëri veprimi i erërave verilindore. Drejtimi veriperëndimor arrijnë vlera të larta shpejtësie në vjeshtë, por ndikimi i tij është i papërfillshëm për shkak të rastisjes së ulët prej 1.3%.

2.2. Mjedisi biologjik

Përshkrimi i habitateve kryesore në zonën e projektit, si dhe harta ilustruese

Zona e studimit është e varfër në bimësi natyrore. Si e tillë është bimësia që gjendet në zonën midis kodrave dhe ligatinave dhe përfaqësohet kryesisht nga barëra halofilikë dhe disa bimë me lule. Për shkak të florës së rrallë edhe fauna është e rrallë. Përveç popullatës së zakonshme të zogjve, ushqimi kryesor i të cilëve sigurohet nga deti, fauna është mjaft e varfër si në numër ashtu edhe në lloje.

Zhvillimi i faunës dhe florës në këtë zonë nuk përcaktohet vetëm nga kushtet e përgjithshme të zonës siç është klima, por edhe nga kushtet specifike si morfologjia, kushtet e tokës dhe ujrave

nëntokësore si dhe mënyrat e përdorimit të tokës. Përfaqësuesit kryesore të zonës janë tipe të ndryshme bari, lulesh dhe shkurresh. Përsa i takon faunës, ka amfibë, gjitarë të vegjël, dhe numër të vogël specimesh insekte. Zogjtë folezojnë dhe shtohen nëpër shkurret jashtë tokave të banuara. Nuk vërehen dëme të veçanta në ekuilibrin natyror të kësaj zone.

Ekzistenca e një rrjeti intensiv kanalesh kushtëzon edhe habitatin e këtyre të fundit. Ai përfaqësohet kryesisht nga barishte të këqija. Fauna përfaqësohet kryesisht nga amfibë (breshka, gjarpërinj dhe bretkoca). Gjitarë të vegjël gjenden më shumë në zonat rrethuese të ligatinave. Kërmijtë hasen shpesh midis bimëve të rralla. Popullatat.

Flora

Ne zonen e studimit janë kryer vërtetime, ku janë plotësuar të dhëna të përgjithshme për vendodhjen, sipërfaqen, pjerresinë, kundrejtimin e diellit, përberjen floristike, si dhe sasi-mbulesën. Vlerësimi i flores është bërë përmes metodikës së vlerësimit të shpejtë, e cila ka si qëllim inventarizimin e llojeve, përcaktimin e sasi mbulesës, lidhjen e ndërsjellte midis formacionit tokësor dhe bimesisë, si dhe faktorët që ndikojnë në habitatin në studim. Inventarizimi dhe përcaktimi i shoqërimeve bimëore është përdorur duke ndjekur metodikën e arealit minimum, e cila konsiston në inventarizimin e llojeve të sipërfaqes bimëore, brenda së cilës nuk ka dallime të theksuara të përberjes floristike. Për këtë, janë përcaktuar paraprakisht dhe ndjekur transektet, bazuar në mbulesën bimëore përfaqësuese, me gjatësi nga 100 – 200 m. Numri më i madh i llojeve është përcaktuar direkt në terren, ndërkohe llojet e panjohura janë vendosur në herbar dhe janë përcaktuar në mjedisin e punës duke u bazuar në librin “Flora Eskursioniste e Shqipërisë”, si dhe studime të tjera në afërsi të zonës në studim. Habitatet dhe llojet janë dokumentuar nëpërmjet fotografive të bëra në terren. Krahas interpretimit, të dhënat e mbledhura në terren janë hedhur në data – baze (emërtimi në latinisht dhe shqip, lista e llojeve në varesi të habitatit, statusi, dhe prezenca).

Më pas jepet një përshkrim më i detajuar për llojet floristike të veçguara drejtpërdrejt në zonën e studimit.

Toka me bar, e lenë djerre

Tokat natyrore dhe gjysmë-natyrore me bar, kanë shtrirje të gjera brenda zonës së studimit, me pjerresinë deri në 5 % dhe kundrejtim nga perëndimi. Ato janë në stadi të ndryshme degradimi dhe në 80% të tyre mbulohen nga bimesi barishtore, me valencë ekologjike të lartë, ku përfshihen: Hithri (*Urtica dioica*), Hithri romak (*Urtica pilulifera*), Mellaga pyjore (*Malva sylvestris*), Lepushka (*Verbascum pulverulentum*), Therlaku (*Aegilops geniculata*), Çikorja e eger (*Cichorium intybus*), Lepjeta (*Rumex acetosa*), Rrodhja (*Arctium lappa*), Gjemb gomari (*Cirsium vulgare*), Luledielli Evropian (*Heliotropium europaeum*), Tatulla (*Datura stramonium*), Ballote e zeze (*Ballota nigra*), Bari mijefletësh (*Achillea millefolium*), Bar muresh (*Parietaria officinalis*), Lule shtogu (*Sambucus ebulus*), Laboti (*Chenopodium botrys*), Pelin fushe (*Artemisia campestris*),

Ushqera (*Echium italicum*), Manaferra (*Rubus ulmifolius*), etj., dhe filiza te rralle arre hinda (*Ailanthus altissima*). Ky lloj habitati ka shtrirje te fragmentuar dhe ne 20 % te saj eshte teresisht i zhveshur mbulesa bimore si rezultat i nderhyrjeve qe jane bere per hapjen e punimeve per ndertimin e impiantit. Diversiteti i llojeve te faunes qe strehon zona eshte shume i ulet, megjithate ajo vizitohet nga shume lloje te tjera qe jane te lidhur me mjediset kufizuese te zones ne studim, por qe e vizitojne ate ne kerkim te ushqimit ose thjesht e perdorin si korridor kalimi.

Kanale ujore dhe kallamishtet

Zona e studimit karakterizohet nga kanale te shumta drenazhimi me ujera mesotrofike, te cilat e kufizojne siperfaqen ku ushtrohet aktiviteti. Me i perhapur ne keto mjedise eshte formacioni i kallamishteve, ku dominojne llojet si Kallamishtja (*Phragmites australis*), Shevari gjethengushte (*Typha angustifolia*) dhe Shqirra (*Scirpus lacustris*). Kjo lloj bimesie eshte shpesh e shoqeruar nga specie si: Kelkaza e ujit (*Alisma plantago-aquatica*), Eleokara e kenetes (*Eleocharis palustris*), Veronika ujore (*Veronica anagallis-aquatica*), Mendra e ujit (*Mentha aquatica*), dhe kallami i madhe (*Arundo donax*). Ky i fundit eshte lloj invaziv dhe ka perhapje te fragmentuar ne zonen e studimit. Vlera e bimesise dhe habitateve te hasur brenda zones se studimit eshte pergjithesisht e ulet, per shkak te diversitetit te ulet te llojeve, si dhe faktit qe ato jane mjaft te zakonshme ne mjedise te ngjashme ne te gjithe vendin.

Fauna

Inventarizimi i llojeve te faunes ne zonen e studimit eshte kryer duke perdorur mjete ndihmese si aparat fotografik, dylbi, dhe celsa te identifikimit. Vrojtimet jane kryer me metoden direkte (evidentimi i kafshes ne habitat) dhe indirekte (gjurmehet ne toke, fece, fole, shenja ne ngrenie, germime ne toke), duke patur si objekt 4 grupe te vertebrorëve (gjitare, shpende, reptile, dhe amfibe). Gjithashtu u moren dhe informacione shtese nga banoret e zones per llojet e kafsheve te para ne te. Per percaktimin e llojeve jane perdorur botimet shkencore si: “Shpendet dhe Gjitaret e Shqiperise”, “Collins Mammal of Europe”, “Collins Bird Guide”, Collins Field Guide Amphibians and Reptiles”, si dhe studime te tjera ne afersi te zones ne studim. Te dhenat e marra jane hedhur ne data – baze (emertimi ne latinisht dhe shqip, preferenca ne habitat, prania, statusi).

Pershkrim i detajuar i llojeve faunistike te zones ne studim.

Bazuar ne vrojtimet ne terren, ne botimet e publikuara per zonat ne afersi, si dhe ne kerkesen e llojit per habitat, vleresohet se ne zonen ne studim gjenden 78 lloje vertebrorëve, ku perfshihen amfibe, reptile, shpende dhe gjitare. Nderhyrjet ne habitatin natyror nepermjet shtimit te ndertimeve, djegies, prerjes se shkurretave dhe kullotjes, kane bere qe zona ne studim te perfaqesohet nga numer i vogel llojesh dhe popullata me desnitet te ulet te tyre. 21 lloje vertebrorësh u vrojtuan ne terren gjate monitorimit. Nderkohe, vleresohet se ne baze te kerkeses se llojit per habitat, shperndarjes gjeografike dhe ekologjise se llojeve, ne zonen e marre ne studim mund te gjenden edhe 57 lloje te tjera. Nga totali i kafsheve te evidentuara, 10 lloje jane pak te rrezikuara (LR), 6 lloje jane me status te ekspozuar ndaj rrezikut (VU), 2 lloje jane me status ne

rrezik (EN), 1 lloj është i kercenuar në mënyrë kritike (CR), dhe për 2 lloj nuk ka të dhëna të mjaftueshme (DD). Me poshtë jepet një përshkrim i detajuar i faunës së pranishme në zonën e studimit.

Në tabelën e mëposhtme (Tabela A) jepen të dhëna mbi numrin e llojeve të rrezikuara.

Table 1 - Listat e llojeve në zonën e studimit

Grupi	Numri i llojeve	Statusi kombëtar
Gjitaret	10 (79)	4
Shpendet	59 (354)	13
Reptilet	6 (37)	5
Amfibet	3 (16)	3
Total i vertebrorëve	78 (486)	25

2.3. Zonat e Mbrojtura

Zonat e Mbrojtura bashkë me Monumentet e Natyrës përfaqësojnë një rrjet sipërfaqesh që mbrohen në shkallë të caktuar, sipas përcaktimeve kategorike të tyre, për shkak të vlerave natyrore kombëtare, por edhe rajonale e globale. Referuar versionit më të fundit të Hartës së rrjetit të ZM të publikuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, zona në të cilën gjendet trualli i propozuar për ndërtim, nuk ndërpret asnjë Zonë të Mbrojtur ose Monument Natyre.

Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive.

Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN. Të gjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive. Zona në vlerësim nuk vlerësohet si zone me status të veçantë nga MTM. Sic shihet edhe në hartën e mëposhtme, zona në vlerësim nuk përmban sipërfaqe të mbrojtura.

Table 2 - Monumentet e Natyrës të rrethit Durrës			
1	Kepi dhe Faleza e Rodonit	5	Shkemb i Kavajes
2	Plazhi i Kallmit	6	Rrapi i Rubjekes
3	Cinari i Balliasit	7	Pylli i Kolndrekajve-Ishem
4	Plazhi i Shenpjetrit		




Figure 5: Pozicioni i prones ne lidhje me zonat e mbrojtura

Siç duket qartë edhe në ortofoton e mësipërme sipërfaqja në të cilën zhvillohet aktiviteti, nuk çënon monumentet e kulturës, zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës. Aktiviteti ynë ndodhet në Autostraden Tirane - Durrës, Zona Kadastrale 2574, Nr. Pasurise 154/177, Xhafzotaj, Durrës. Kjo zone ka një distancë të konsiderueshme nga zonat e mbrojtura me të afërta.

2.4. Mjedisi socio-ekonomik

Të dhëna të përgjithshme

Zona ekonomike propozohet të zhvillohet në territorin e Bashkisë Durrës. Bashkia e Durrësit shtrihet përgjatë bregut të detit, nga grykëderdhja e lumit Ishëm në veri deri në kufi me Kavajën në jug dhe kufizohet në perëndim me Detin Adriatik, në veri me bashkinë Kurbin, në lindje me bashkitë Krujë, Vorë e Shijak dhe në jug me bashkinë Kavajë.

Kjo bashki përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz, të gjitha pjesë të rrethit Durrës, qarku Durrës. Në territorin e bashkisë së re gjenden tre qytete, Durrës, Sukth dhe Manëz si dhe 39 fshatra. Qendra e bashkisë është qyteti i Durrësit i cili është një ndër qytetet më të vjetër të Shqipërisë dhe qyteti port më i madh dhe më i rëndësishëm i vendit. Ai është qyteti i dytë më i madh pas Tiranës, si në pikpamje të zhvillimit ekonomik ashtu edhe të popullsisë. Ai shtrihet në një gadishull të vogël në brigjet e detit Adriatik dhe është krijuar në vitin 627 BC, nga kolonët korintas dhe të Korfuzit, në territoret e vendbanimit të fisit ilir të taulantëve.

Durrësi ndodhet rreth 35 km larg Tiranës kryeqytetit të Shqipërisë. Është qendra e sistemit hekurudhor shqiptar dhe ka gjithashtu portin më të madh në Shqipëri. Porti i Durrësit, është një nga portet më të vjetra të Europës në detin Adriatik dhe një nga kryeurat ballkanike të komunikimit të perëndimit me lindjen dhe anasjelltas.

Durrësi është nyje e të gjitha llojeve të transportit. Ai është përcaktuar si një pikë hyrje për Korridorin e 8-tëtë transportit që fillon nga Shqipëria, kalon nëpërmjet Maqedonise dhe Bullgarisë për të mbërritur në portin e Varnas dhe Burgasit në Detin e Zi. Mjedisi shumë i favorshëm, mundëson krijimin e zonave industriale, krijimin e plazheve elitare në zona të virgjëra, studime e master plane, zbulime arkeologjike, ndërtime të rrugëve të reja dhe përmirësimin e infrastrukturës.



Figure 6: Harta e bashkise Durrës

Njesia e qeverisjes vendore qe administron zonen ku zbatohet projekti

Zona Gjeografike: Bashkia Durrës kufizohet në perëndim me Detin Adriatik, në veri me bashkinë Krujë, Vorë e Shijak dhe në jug me bashkinë Kavajë. Kurbin,

Kjo bashki përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz.

Të gjitha njësitë e bashkisë së re bëjnë pjesë në rrethin Durrës, qarku Durrës. Në territorin e bashkisë së re gjenden tre qytete, Durrës, Sukth dhe Manëz si dhe 39 fshatra.

Bashkia e Durrësit shtrihet përgjatë bregut të detit, nga grykëderdhja e lumit Ishëm në veri deri në kufi me Kavajën në jug.

Vija e gjatë bregdetare që i shtohet qytetit të Durrësit e thekson tiparin e kësaj bashkie si zonë turistike, pasi përveç plazhit të Durrësit asaj i shtohet i gjithë gjiri i Lalëzit si dhe Kepi i Rodonit, të cilat deri tani kanë qenë pjesë e komunave Ishëm, Sukth, Katund i Ri dhe Rrashbull.

Durrësi ka gjithashtu portin më të madh në Shqipëri, ku përpunohet mbi 90 për qind e të gjithë volumit të ngarkim-shkarkimit portual, gjë që e bën atë njën më të rëndësishme tregtare në vend.

Për shkak të lehtësisë që krijon porti, Durrësi është zhvilluar edhe si një qytet i rëndësishëm për manifakturën, ndërsa joshja nga turizmi ka shkaktuar gjatë dy dekadave të fundit një bum në sektorin e ndërtimit.

Durrësi është një zonë me shkallë të lartë të migrimit të brendshëm, gjë që ka sjellë zgjerimin e shpejtë dhe informal të qytetit në zonën e ish-Kënetës si dhe përgjatë vijës bregdetare në jug të qytetit.

Durrësi është gjithashtu një zonë e rëndësishme arkeologjike, pasi nën qytetin aktual gjenden disa shtresa qytetërimesh antike. Zbulimet arkeologjike janë të shumta, ndërsa ndërtimet e dekadave të fundit kanë dëmtuar një pjesë të kësaj trashëgimie.

Popullsia dhe aktivitet kryesore ekonomike te zones

Popullsia: Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Durrës banojnë 175,110 vetë ndërsa sipas regjistrit civil popullsia rezidente është 299,989 vetë. Me një sipërfaqe prej 338.30 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit 2011 është 517 banorë km² ndërsa sipas Regjistrit Civil është 680 banorë km².

Kjo bashki përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz.

Të gjitha njësitë e bashkisë së re bëjnë pjesë në rrethin Durrës, qarku Durrës. Në territorin e bashkisë së re gjenden tre qytete, Durrës, Sukth dhe Manëz si dhe 39 fshatra.

Bashkia Durrës

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrimit Civil	Sipërfaqja KM ²
Durrës	Qyteti Durrës	Durrës	Qyteti Durrës	175,110	299,989	338.3
		Sukth	Qyteti Sukth, Fshatrat; Hamallaj, Kullë, Perlat, Vadardhë, Rushkull, Hidrovori			
		Ishëm	Fshatrat; Likmetaj, Kërtushaj, Kapidanaj, Gjuricaj, Lalëz, Kuraten, Bizë, Draç, Shetaj,			
		Katundi i ri	Fshatrat; Katundi i ri, Jubë, Qerret, Flakë, Bisht-Kamëz, Rinia, Erzen, Sukth, Adriatik			
		Rrashbull	Fshatrat; Rrashbull, Arapaj, Shënavlash, Shkallnur, Manskuri, Romanat, Bozanhije, Xhafzotaj,			
		Manëz	Qyteti Manëz, Fshatrat; Armath, Borç, Hamallaj, Kamas, Radë, Shkallë, Fshat Manëz			

Durrësi ka portin më të madh në Shqipëri, ku përpunohet mbi 90 për qind e të gjithë volumit të ngarkim-shkarkimit portual, gjë që e bën atë njëjën më të rëndësishme tregtare në vend.

Me mbi 5600 aktivitetet ekonomike të tij dhe 15% të investimeve të huaja, Durrësi është renditur në vendin e dytë si ekonomia më e fortë e vendit, pas Tiranës.

Në sektorin e prodhimit, 45% e ndërmarrjeve zhvillojnë aktivitet në industrinë ushqimore, ndërsa pjesa tjetër prej 55% në industrinë e lehtë.

Në industrinë ushqimore aktivitet kryesore janë furrat e bukës, përpunimi i mishit (prodhim sallamesh e proshutash), prodhimi i birrës, kantinat e verës, fabrikat e miellit dhe prodhimit të brumrave etj.

Industria e lehtë përfshin aktivitete të tilla si prodhim veshmbathje dhe këpucë, prodhime alumini, prodhim kimikatesh, industri e përpunimit dhe riciklimit të letrës, prodhim i lëndëve larëse.

Kompanitë e tjera zhvillojnë aktivitete në fushën e turizmit, ndërtimit, tregtisë dhe komunikacionit. Sipas të ardhurave që realizojnë, 829 prej tyre konsiderohen si aktivitete të biznesit të madh.

Ndër kompanitë më të mëdha që zhvillojnë aktivitet në rrethin e Durrësit renditen AIBA kompani (prodhim i vezëve dhe një ndër më të mëdhatë në vend me aktivitet edhe në tregjet lokalë), kantina e pijeve alkolike Gjergj Kastrioti Skënderbeu, SUCRALBA (përpunim dhe paketim artikujsh

ushqimorë si sheqer, oriz, makarona etj.), ALBMAR (përpunim peshku, eksportuese produktesh), TEUTA EB, ALBI F etj.

Porti i Durrësit mbulon rreth 85% të import-eksporteve shqiptare të mallrave dhe pjesën më të madhe të transportit detar të udhëtarëve. Në portin e Durrësit ngarkohen dhe shkarkohen të gjitha llojet e mallrave minerale, karburante, çimento dhe artikuj të kategorive të ndryshme. Në port gjendet dhe terminali i trageteve.

Për shkak të lehtësisë që krijon porti, Durrësi është zhvilluar edhe si një qytet i rëndësishëm për manifakturën, ndërsa joshja nga turizmi ka shkaktuar gjatë dy dekadave të fundit një bum në sektorin e ndërtimit.

Turizmi veror dhe kulturor është një industri me ndikim të rëndësishëm në ekonominë e Durrësit. Me mbi 750.000 vizitorë në vit, kjo është zona më e rëndësishme e vendit në lidhje me turizmin masiv. Sipas Zyrës Rajonale të Punës të Durrësit, forcat aktive për të punuar llogariten rreth 54,000 njerëz.

Niveli i të papunëve për rrethin e Durrësit shkon në rreth 10,38%, ku papunësia është më e përhapur te femrat. Sektori privat ka punësuar rreth 31,3%, i ndjekur nga sektori bujqësor privat me 36,7%, dhe sektori shtetëror me 21.3%.

Kapitulli 3 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme si pasojë e veprimtarisë është bërë duke u nisur nga një sërë faktorësh që lidhen me natyrën e veprimtarisë, teknologjinë e përdorur, mënyrën e operimit, sasinë e energjisë, lëndët e para të përdorura dhe mbetjet e gjenerura, të gjitha këto në kontekstin e kushteve dhe vlerave egzistuese të zonës së projektit, faktorëve favorizues dhe kufizues mjedisorë për zhvillimin e projektit dhe zonave të ndjeshme fizike dhe shoqërore të identifikuara gjatë punës në terren.

3.1. Metodika e vlerësimit të ndikimeve të mundshme negative në mjedis

Për identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis nga zhvillimi i këtij projekti, u ndoqen hapat e mëposhtme;

- Njohja me bazen ligjore në fuqi;
- Njohja me projektin e zbatimit dhe teknologjinë që të përdoret;
- Njohja me ciklin e trajtimit të mbetjeve;
- Njohja me lëndët e para dhe mjetet që do të përdoren;
- Njohja me infrastrukturen ekzistuese të zonës ku do të zhvillohet projekti;
- Njohja dhe shkelja nga afer e të gjithë zonës së studimit për vlerat natyrore dhe mjedisore;
- Njohja me dokumenta dhe raporte të VNM dhe veprimtarive të ngjashme;
- Konsultimi me banorët e zonës dhe njësinë e qeverisjes vendore;

3.2. Lloji i ndikimeve të identifikuara

Ndikimet e mundshme gjatë fazës së funksionimit të aktivitetit mund të përmbledhen sipas elementeve të mjedisit, si më poshtë:

3.2.1. Shkarkimet në ujë

Ujerrat të cilët shkarkohen nga ky lloj aktiviteti, janë ujerrat e zakonshëm urbane, të cilët gjenerohen nga ambientet higjieno-sanitare të objektit dhe aktivitetit human. Në rast se do të kemi shkarkime të tjera përveç ujërave sanitare, do të bëhet vlerësimi i tyre sipas kërkesave ligjore në fuqi. Elementet që do të përdoren në këtë teknologji janë elemente që nuk treten në ujë. Si rezultat nuk do të kemi ndotje të ujërave nëntokësore apo ujërave sipërfaqësore.

3.2.2. Shkarkimet në ajër

Procesi i prodhimit të skedave elektronike nuk vlerësohet të ketë ndikim nëpërmjet shkarkimeve në ajër. Linja teknologjike e prodhimit të skedave elektronike është pajisur me sistem të kapjes dhe filtrimit të tymit që gjenerohen nga procesi i saldimit (qofte manual qofte automatik me

makineri) edhe pse sasia e këtij tymi është e papërfillshme. Nepermjet këtij sistemi behet filtrimi dhe shkarkimi i tyre ne ajër nepermjet sistemit te aspirimit.

3.2.3. Mbetjet e ngurta

Mbetjet e ngurta qe gjenerohen nga ky aktivitet jane mbetje urbane nga aktiviteti njerezor I punonjesev si edhe mbetje te ngurta procesi I punes. Mbetjet e ngurta qe mund te gjenerohen jane nga ambalazhet e lendeve te para apo gjate procesit te prodhimit te skedave elektronike, ku permendim edhe skorie kallaji (gjenerohet nga procei I saldimit dhe pjesa qe mbetete pasi trajtohet ne makinerine e riciklimit te kallajit konsiderohet skorie kallaji) do te menaxhohen sipas kerkesave ligjore ne fuqi.

3.2.4. Ndikimet nga zhurmat

Gjate procesit te punes kemi gjenerim te zhurmave si pasoje e vanies ne pune te makinerive dhe pajisjeve te ndryshme qe subjekti ka ne perdorim. Gjykuar nga pozicioni i zones, me aktivite te shumta dhe nje levizje te dendur te automjeteve, themi se ndikimi nga zhurmat eshte i ulet pasi aktiviteti nuk do te gjeneron zhurma qe kalojne nivelin e zhurmave ne kete zone.

3.2.5. Ndikimet sociale

Persa i perket ndikimeve sociale themi se jane me kah pozitiv. Kompania do te punesoje punonjes duke u ofruar kushte te mira pune dhe nje page mujore e cila rrite ekonomite e tyre familjare.

Gjithashtu nepermjet sistemit te taksimit kompania gjeneron te ardhur ne buxhetin e shtetit.

KAPITULLI 4 PROGRAMI I PËRMIRËSIMIT TË PROCESIT TË PUNËS DHE MASAT ZBUTESE

Për plotësimin e kërkesave të klientëve, rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, rritjen e masave të sigurisë gjatë procesit të operimit në ruajtjen/magazinin, tregetim, mbrojtjen nga gazrat, pluhurat, zhurmat, etj, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe komunitetit të zonës përreth, me qëllim kryesor “Mbrojtjen e Mjedisit”, reduktimin e sasisë së emetuar të PM10, CO2, NOx, SOx në atmosfere, përdorimin e energjisë në mënyrë efikente, duke menduar për gjeneratat e brezave pasardhës, subjekti “RCF INDUSTRIES” Sh.p.k, ka hartuar “Programin e Përmirësimit të Operimit të Proceseve Teknike të Punës”, sipas termave të mëposhtme.

Programi i përmirësimit të operimit mbështetet në këto parime të zbatueshme:

4.1 Masat e nevojshme për zbutjen e ndikimeve

Masat kryesore të propozuara në Planin e Menaxhimit të Mjedisit duhet të adresojnë zgjidhjet më optimale për minimizimin e ndikimeve të identifikuara negative në mjedis. Këto masa duhet të synojnë:

- Kontrollin dhe mbajtjen e ndikimeve brenda zonës së punimeve;
- Shmangien e efekteve negative në shëndet dhe mjedis.

Zbatimi me korrektësi i këtyre masave do të bëhet i mundur nga përdorimi i teknikave të mëposhtme:

- Piketimi i saktë i sipërfaqes ku zhvillohet aktiviteti, si dhe kufizimi i veprimtarisë vetëm brenda saj;
- Plan - organizimi në mënyrë që të mos impaktohen sipërfaqet jashtë ndërhyrjes; Kontrolli i mbetjeve të gjeneruara gjatë procesit të punës;
- Hapja e kanaleve të nevojshëm perimetral për kullimin drejtimin e ujrave të shiut, me qëllim shmangien e ndotjes në ujëra;
- Kontrolli i pluhurave nëpërmjet sistemit të kapjes dhe filtrimit;
- Kontrolli i shkarkimeve në ajër nëpërmjet instalimit të filtrave të posacem;
- Kontrolli teknik i makinerive dhe pajisjeve të instaluar;
- Kontrolli teknik i automjeteve për të parandaluar rrjedhjet e karburantit dhe çlirimet e tyre të gazeve.

4.2 Masat Parandaluese

- Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit për mënyrën e veprimit gjatë proceseve të ndryshme në aktivitet.
- Zbatim rigoroz i sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së sajë në rast avarie të mundshme.
- Montimi i të gjithë aparateve sinjalizuese të sigurisë dhe rrjetit elektrik.
- Tokëzimi dhe rrufe pritëse, në të gjith instalimet për të shmangur aksidente me pasoja në mjedis.
- Mbajtja gjithmone fikur e automjeteve kur nuk është e nevojshme përdorimi i tyre dhe ruajtja e distancës së sigurisë, gjatë operimit të punës nga punonjësit;
- Mbajtja e pajisjeve të nevojshme, nga punonjësit për operimin e punës,
- Lyerja e ambientit të punës (zyra, magazine) dhe pajisjeve me bojë antikorrozive (kundra ndryshkut) çdo dy vite sipas një programi të veçantë, me qëllim mbrojtjen nga korrodimi.
- Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut, si dhe mirëmbajtja e pemëve.
- Kolaudimi periodik i mjeteve të transportit
- Monitorimi periodik i parametrevë mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë.

4.3 Masat Kontrolluese

- Kontroll i automatizuar i të gjithë linjës së instalimit, nëpërmjet programeve inxhinierike;
- Pastrimi i sheshit ku zhvillohet aktiviteti dhe atij të lëvizjes së automjeteve.
- Pastrimi i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut përgjatë perimetrit nën administrimin e shoqërisë ku zhvillohet aktiviteti.
- Vëzhgimi dhe kolaudimi i vazhdueshëm i të gjithë makinerive të transportit.
- Monitorimi periodik i parametrevë mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë.
- Sigurimi i të gjithë pajisjeve të nevojshme për riparimin, pastrimin dhe ndërhyrje në rast emergjencash.
- Trajnimi periodik i punonjësve dhe njohja me planin e ndihmës së shpejtë dhe planin e përballimit të emergjencave të ndryshme.

4.4 Masat Nderhyrese

- Riparimi i menjehershëm i difekteve dhe avarive teknologjike
- Mobilizimi i menjehershëm i stafit dhe mjeteve të fikjes së zjarrit.
- Kolaudimi dhe shërbimi i pajisjeve/makinerive nga ekspertë të licensuar, çdo fillim viti.
- Kapja, asgjësimi i menjehershëm në rastet e derdhjeve të lubrifikantëve dhe pastrimi i menjehershëm i ambientit të punës me detërgjente të posaçëm, që mund të gjenerohen nga veprimtaria dhe automjetet që kryejnë këtë shërbim.
- Zëvendësimi i menjehershëm të pjesëve të pajisjeve/ makinerive dhe mjeteve të punës, në rastet e avarive të mundshme.
- Rigjenerimi i ambientit të dëmtuar.
- Riparimi i menjehershëm i teknologjisë dhe automjeteve, në raste avarie të mundshme apo dëmtim të instalimeve.
- Në rastet e avarive të ndryshme do të njoftohet i gjithë stafi i punonjësve dhe klientët e gjendur aty, me qëllim sigurimin e jetës së tyre dhe ndërhyrjen për sigurimin e automjeteve dhe pajisjeve kryesore.
- Njoftimi i organeve kompetente, për rastet e mundshme.
- Pajisja e zones së aktivitetit me sinjalistikën e duhur dhe shenjat dalluese në rastet e rrezikut të mundshëm, për operimin normal të punës në objekt.
- Njoftimi i menjehershëm i automjeteve dhe njësive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikëse, autoambulanca, etj).
- Rrethimi i perimetrit të territorit në shfrytëzim.

4.5 Masa lehtësuese për funksionimin eficient dhe të sigurtë të punës në aktivitetin e transferimit të mbetjeve:

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum përdorimi i mjeteve të transportit kur nuk është e nevojshme dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Lejen Mjedisore që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhurnohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe

ndryshimeve të tij.

- Është detyrë e zhvilluesve të aktivitetit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e Njesise Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Do të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyre periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikanteve dhe hidrokarbureve në mjedis, emëtimin e gazeve dhe zhurmave të tepërta të shkaktuara nga avari të mundshme teknike të mjeteve.
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe efikasitetit që kanë në kryerjen e operacioneve të transferimit të mbetjeve
- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjienike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjeno-Sanitare.
- Do të bëhet menaxhimi i mbetjeve të ngurta, të cilat do të jenë; lëndë të ambalazheve, letra- kartona, si dhe lëndë organike të prodhuara nga punonjësit, ku këto mbetje do të transportohen rregullisht në vendin e caktuar nga Njësia Vendore, ku firma do të marrë masa për menaxhimin e këtyre mbetjeve të ngurta, do të vendosen në kosha selective sipas rrymave specifike të mbetjeve.
- Do të bëhet pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujërave të shiut në këtë objekt ose e mjedisit përreth drejt mjediseve të gjelbëruara. Mjedis i gjelbëruar përreth do të jetë nën kujdesjen e personelit që do të punësohet vetëm për punimet agro-mjedimore të nevojshme.
- Aktiviteti disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksive, etj.
- Është ndertuar sistemi i drenazhimit dhe lëvizjes së ujërave të shiut.
- Do të bëhet trajnimi periodik i punonjësve mbi kushtet e sigurimit teknik gjatë operimit të punës, si dhe të kualifikohen stafi përgjegjës për operimin e punës në instalimin për ruajtjen/magazinimin transferimin e mbetjeve.

KAPITULLI 5 PROGRAMI MONITORIMIT

5.1 Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

5.2 Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të tij.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e funksionimit të aktivitetit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku zhvillohet aktiviteti dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

5.3 Plani i monitorimit

Plani i monitorimit do të konsistojë në:

- Monitorimi i parametrave tectin të instalimit.
- Monitorimi i zonës së mundëshme të gjenerimit te aromave gjate zhvillimit te veprimtarise
- Monitorimi i parametrave fizike dhe dinamike të shpërndarjes së emetimeve te gazeve dhe marrja e masave përkatëse të parashikuara në projekt, për parandalimin e tij.
- Monitorimi i shkarkimit të ujrave të ndotura ne siperfaqen e aktivitetit
- Monitorimi I mbetjeve te gjeneruara;

Indikatorët e mësipërm të monitorimit janë një ndërthurje treguesish me të cilët vlerësohet shumë objektivisht trysnia që ushtron funksionimi I ketij aktiviteti në mjedis, si dhe gjendja e mjedisit, ndikimit të funksionimit të instalimit të zbatuar në këtë gjendje. Matja dhe mbledhja e të dhënave për treguesit e mësipërm eshte bërë konformë metodave dhe teknikave shkencore të njohura dhe të pranueshme. Të dhënat që do të mblidhen do të vihen në dispozicion të organeve shtetërore dhe të interesuarve të tjerë, gjithashtu këto të dhëna do të analizohen me qëllim përmirësimin e performances mjedisore të veprimtarisë dhe bërjen e korigjimeve të nevojshme.

Në monitorimin e sipërfaqeve të mbjella të pemëve dhe bimëve të mbjella, ecurinë normale të mbirjes dhe zhvillimit të tyre.

Në rastet kur vërehet se ka dëmtime merren masa për zevëndësimin me fidanë të rinj.

Monitorimi i çdo sipërfaqe të mbjelle do të vazhdoje për një periudhe 4 vjecare kohë gjatë së cilës bimët kanë marrë një zhvillim të konsiderushëm dhe nuk kanë nevojë për shërbim.

KAPITULLI 6 REKOMANDIME

1. Mbetjet e ngurta te menaxhohen sipas kerkesave ligjiore ne fuqi.
2. Te jete funksional sistemi i aspirimit te ndertesese.
3. Shoqeria te operoje ne perputhje te plote me normat qe jane ne fuqi, dhe te kryej monitorime te vazhdueshme te tregueseve mjedisore te trysnise ne mjedis.
4. Te respektohen te gjitha rregullat e mbrojtjes kundra zjarrit gjate operimit ne fabrike dhe te zbatohet rregullorja e MKZ.
5. Per te minimizuar impaktin ndaj zhurmave, aromave dhe dridhjeve, punonjesit te paisen me mjete mbrojtese si kufje, doreza, veshje te posacme ose maska me filter per aromat.
6. Mbetjet e produktit te cilat jane te menaxhueshme, te menaxhohen nga subjekti duke u ricikluar dhe riperdorur, ose duke i shitur ne subjekte te tjera te specializuara dhe me teknologjine dhe ambjentet e pershtatshme per menaxhimin e ketyre lloj mbetjesh.
7. Te kryhen monitorimet rregullisht dhe te dorezohen prane Struktures pergjegjese per mjedisin.
8. Te respektohen te gjitha masat per sigurine ne pune dhe per mbrojtjen e mjedisit
9. Te respektohen te gjitha kushtet dhe masat qe do te vendosen ne Lejen Mjedisore.
10. Subjekti te jete ne dijeni te kuadrit ligjor per mjedisin dhe te ndryshimeve te tij.
11. Rekomandojme qe subjekti, ne baze te kushteve mjedisore dhe ndikimit ne mjedis te paiset me Certifikaten e cilesise ISO: 14000 dhe ISO: 14001.